

## Njehsimi i kopjeve me origjinalin

### Përshkrimi

Njehsimi i kopjeve të dokumenteve të lëshuara nga autoritetet shqiptare ose autoritetet e vendit pritës me origjinalin.

### Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Dokument identifikimi si pasaportë ose kartë identiteti biometrike i personit që paraqet dokumentin për t'u njehsuar;
- 2) Dokumenti origjinal, i vlefshëm dhe i lëshuar nga autoriteti përgjegjës;

### Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personalisht e personit të interesuar para konsullit ku bëhet verifikimi i identitetit të tij;
- 2) Dorëzimi i mandat-pagesës origjinale të tarifës, që ka derdhur në numrin e llogarisë së përfaqësisë;
- 3) Verifikimi i rregullshmërisë së dokumentit;
- 4) Verifikimi me autoritetin lëshues, nëse është e nevojshme;
- 5) Njehsimi i kopjes me origjinalin;
- 6) Kopje e dokumentit, pasi është bërë njehsimi me origjinalin dhe i është vendosur pulla taksë, mbahet në arkivin e ambasadës apo konsullatës

### Tarifa e shërbimit dhe afati

20 euro ose tarifa ekuivalente me monedhën vendase

Veprimi kryhet me paraqitjen e interesuarit ose në varësi të kohës së nevojshme për verifikim me autoritetin lëshues.

### Zyra

Të gjithë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

### Shënime

Në rastet kur konsulli nuk është i bindur për vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga shtetasi, ai kryen procedurat e verifikimit të tyre nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme ose Institucioneve të vendit ku është lëshuar dokumenti.

Në vendet që nuk ka Ambasadë apo Konsullatë shqiptare, të interesuarit i drejtohen noterëve vendas. Për t'u njohur nga autoritetet në Shqipëri vërtetimet e noterëve vendas duhet të legalizohen ose apostilohen, si çdo dokument tjetër i huaj.